



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI AKADEMIK

Nr. 551 prot.

Shkodër, më 23.04 2026

V E N D I M

Nr. 130, datë 23.04.2026

“Për miratimin e tarifës dhe masës së pagesës së pedagogëve për zhvillimin e kurseve të gjuhës shqipe, si dhe caktimin e numrit të pjesëmarrësve në kurs ”

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 3 pika 4, germa a; Statutin e USH-së, Neni 38, pika 3, Statutin e USH-së, Neni 17, pika 6, germa nj, Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 23.04.2026

Vendosi:

1. Miratimin e tarifës prej 5000 lekësh për regjistrim të të interesuararve për “Certifikimin e njohurive mbi gjuhën shqipe” (në rast njohjeje të kësaj gjuhe), si dëshmi institucionale.
2. Miratimin e pagesës së pedagogëve për zhvillimin e kurseve të gjuhës shqipe, në masën 70% të të ardhurave nga çdo kurs dhe 30% për shpenzimet institucionale.
3. Miratimin e pagesës së pedagogëve për përfshirjen në komision certifikimi të njohurive mbi gjuhën shqipe (pa nevojë kursi), në masën 70% të të ardhurave për pedagogët dhe 30% për Institucionin.
4. Miratimin e zhvillimit të kurseve të gjuhës shqipe me jo më shumë se 5 pjesëmarrës.
5. Ky vendim t’i përcillet Bordit të Administrimit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI"
KRYETARI I SENATIT
Prof. Dr. **Tomir GJURAJ**